

Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë

Varshavë, Poloni

Nga data 23 deri 26 shtator 2013

Rezolutë mbi profilizimin

Pasi u diskutua mbi çështjen e profilizimit gjatë seancës e dyer të mbyllura të Konferencës së 34-të ndërkombëtare të zhvilluar në Uruguai dhe pasi u mor dijëni mbi opinionin e ekspertëve të sektorit publik dhe privat gjatë kësaj seance;

Duke pasur dijëni mbi shumë aplikacione të dobishme të megadata-s dhe përparësitë që mbledhja masive e të dhënave mund t'i sjellë segmenteve të ndryshme të shoqërisë, aq sa ndërmarrjeve ashtu edhe qeverive dhe organizmave jo fitimprurëse;

Duke ditur më së miri se rreziku është akoma më i madh kur kombinohet tërësia e të dhënave pa përlogaritur siç duhet mbrojtjen e të dhënave dhe qëllimet për të cilat ato janë mbledhur fillimisht;

Duke risjellë në mendje parimet e përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë;

Duke ritheksuar Deklaratën mbi profilizimin, të miratuar në 2012-ën në Uruguai;

Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë nxit të gjitha palët që kryejnë profilizim:

1. Të përcaktojnë qartë nevojën dhe përdorimin praktik të çdo aktiviteti profilizimi dhe të garantojnë marrjen e masave të përshtatshme të sigurisë, përpara kryerjes së profilizimit;
2. Të kufizojnë, konform parimit të mbrojtjes së privatësisë, që nga faza e konceptimit, hipotezat dhe sasinë e të dhënave të mbledhura në nivelin e nevojës, për qëllime të ligjshme të parashikuara dhe nëse është rasti, të sigurohen se të dhënat janë mjaftueshmërisht të sakta dhe të përditësuara për qëllimet e parashikuara;
3. Të sigurohen se profilet dhe algoritmet themelore, janë të vlefshme në vazhdimësi, për të bërë të mundur përmirësimin e rezultateve dhe zvogëlimin e numrit të rezultateve pozitivisht apo negativisht të rreme;
4. Të informojnë shoqërinë për aktivitetet e profilizimit, aty ku është e mundur, përfshirë edhe për mënyrë e ndërtimit të këtyre profileve dhe për qëllimet për të cilat ato po përdoren, me qëllim që individët të mund të ruajnë kontrollin e të dhënave të tyre personale, aty ku është mundësia dhe vendi;
5. Të sigurohen, sidomos për atë që i përket vendimeve të cilat kanë pasoja ligjore të rëndësishme mbi personat apo ndikon në përparësitë apo statusin e tyre, që këto persona

të jenë të informuar mbi të drejtën e tyre për të kontrolluar dhe korigjuar të dhënat e tyre personale dhe të kenë mundësi për ndërhyrje njerëzore nëse është rasti, veçanërisht nëse kihet parasysh kapaciteti parashikues gjithnjë e më i madh i profilizimit për shkak të efektshmërisë në rritje të algoritmeve;

6. Të sigurohen se të gjitha aktivitetet profilizuese janë subjekt i një mbikëqyrjeje të mjaftueshme.

Komisionerët kërkojnë për më tepër, që qeveritë e të gjithë botës, të garantojnë transparencën dhe t'i japin popullsisë dhe palëve të përfshira, mundësinë të shprehin këndvështrimin e tyre në kuadër të secilit proces që lidhet me miratimin e ligjeve, të cilat parashikojnë perkufizimin e aktiviteteve të profilizimit.